



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Numri i lëndës: 2021:000417
Datë: 03.10.2024
Numri i dokumentit: 06245611

K.DH.Shk.II.nr. 1512/24

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhoma e shkallës së dytë, me gjyqtarin Faton Bajrami në çështjen përbarimore të kreditorit “Wurth Kosova”, sh.p.k, me seli në Llapnasellë, me adresë magjistrálja Prishtinë, Ferizaj, km 7, Graçanicë, të cilën e përfaqëson B.B. nga Suhareka, kundër debitorit “B.T.”, B.I (Al Bau), rr. “Besim Shala”, pn, Prizren, me bazë juridike përbarimore, duke vendosur lidhur me ankesën e debitorit të ushtruar kundër aktvendimit të Gjykatës Themelore në Prizren, Departamenti i Përgjithshëm, PPP.nr.01/2021 të datës 10.06.2022, me datë **02.10.2024**, mori këtë:

A K T V E N D I M

REFUZOHET si e pathemeltë ankesa e debitorit “B.T.”, B.I (Al Bau), ndërsa aktvendimi i Gjykatës Themelore në Prizren, Departamenti i Përgjithshëm, PPP.nr.01/2021 të datës 10.06.2022, **VËRTETOHET**.

A r s y e t i m

Gjykata Themelore në Prizren, Departamenti i Përgjithshëm, me aktvendimin e atakuar PPP.nr.01/2021 të datës 10.06.2022, në dispozitiv të aktvendimit ka refuzuar në tërësi si të pabazuar prapësimin e debitorit “B.T.”, B.I (Al Bau), ushtruar ndaj Urdhrit Përbarimor P.nr. 107/2020, i lejuar me datë 06.06.2022, nga Përbaruesi Privat Arben Gashi.

Kundër këtij aktvendimi në afatin ligjor ka ushtruar ankesë debitori (*me pretendime sikur në ankesë*), me propozim që Gjykata e Shkallës së Dytë, të aprovoj ankesën si të bazuar dhe të ndryshohet aktvendimi i Gjykatës Komerciale, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, PPP.nr.01/2021 të datës 10.06.2022.

Gjyqtari individual i Gjykatës Komerciale i shqyrtoi shkresat e lëndës, aktvendimin e atakuar dhe pretendimet ankimore, në kuptim të nenit 3, paragrafi 2, të Ligjit nr.04/L-139 për Procedurën Përmbartimore si dhe në kuptim të nenit 194 dhe 208 të LPK-së, gjeti se:

- **Ankesa e debitorit është e pathemeltë.**

Nga shkresat e lëndës rrjedh se Përmbartuesi Privat, duke vepruar sipas propozimit të kreditorit, mbi bazën e dokumenteve të besueshme; Faturës nr. 19-SHV01-001-7526 dhe fatura nr.19-SHVO1-8184, ka lejuar Urdhrin Përmbartimor P.nr. 107/2020, i lejuar me datë 06.06.2022, për shkak të detyrimit në të holla në shumën prej 5,310,62€ me kamatë ligjore prej 8%, si dhe shpenzimet e procedurës përmbartimore.

Debitori, brenda afatit ligjor ka ushtruar prapësim me të cilin e ka kundërshtuar urdhrin përmbartimor, duke kontestuar ligjshmërinë e urdhrit për lejimin e përmbartimit, andaj nga gjykata ka kërkuar që prapësimin e debitorit ta aprovoj si të bazuar.

Kreditori, në përgjigje në prapësim ka kundërshtuar pretendimet e debitorit si të pabazuara, andaj gjykatës i ka propozuar që ta lë në fuqi urdhrin përmbartimor P.nr.107/2020 të datës 22.07.2020.

Gjykata Themelore në Prizren, Departamenti i Përgjithshëm, duke vendosur lidhur me prapësim e debitorit dhe përgjigjen në prapësim të kreditorit, ka nxjerrë aktvendimin e atakuar PPP.nr.01/2021 të datës 10.06.2022, ku në dispozitiv të të njëjtit ka refuzuar në tërësi si të pabazuar prapësimin e debitorit “B.T.”, B.I (Al Bau), ushtruar ndaj Urdhrit Përmbartimor P.nr. 107/2020, i lejuar me datë 06.06.2022, nga Përmbartuesi Privat Arben Gashi.

Në arsyetim të aktvendimit gjykata ka vlerësuar se fatura mbi bazën e së cilave është lejuar urdhri përmbartimor, i plotëson kushtet e përcaktuara për zbatimin e përmbartimit në bazë të dokumentit të besueshëm.

Nisur nga kjo gjendje e çështjes, Gjykata Komerciale – Dhoma e shkalles se dytë, vlerëson se gjykata e shkallës së parë i ka zbatuar drejtë dispozitat e Ligjit të Procedurës Përmbartimore kur e ka refuzuar prapësimin e debitorit, ngase edhe sipas vlerësimit të kësaj gjykate me shikimin në shkresat e lëndës qartë konstatohet se përmbartimi është lejuar në bazë të faturës të lëshuar nga kreditori, e cila faturë përmban elementet që kërkohen me nenin 29 paragrafi par.3 i cili përcakton se “*Dokumenti i besueshëm është i përshtatshme për përmbartim po që se ne të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, lloji, shuma dhe koha e përmbushjes se detyrimit monetar*”.

Gjykata e shkalles se dytë, vlerëson se gjykata e shkallës së parë në bazë të provave të cilat i ka pasur në dispozicion në shkresat e lëndës, ka dhënë aktvendim ne pajtim me dispozitat ligjore, prandaj përfundimin juridik të gjykatës së shkallës së parë, lidhur me këtë çështje e pranon edhe gjykata e shkallës e dytë, me çka mbi bazën e këtyre rrethanave dhe fakteve kësaj

gjykatë i rezultoi se aktvendimi i ankimuar i nxjerrë nga gjykata e shkallës së parë është i drejtë dhe i bazuar.

Gjykata e shkallës së dytë bazuar në Udhëzimin administrativ Nr.15/2010 PËR ZBATIMIN E LIGJIT NR. 03/L-222 MBI ADMINISTRATËN TATIMORE DHE PROCEDURAT, i cili në nenin 20 par.1 nenpar.1.17 parasheh që “Në minimum, një faturë duhet të jetë e nënshkruar nga shitësi, nëse klienti apo blerësi është dispozicion për të nënshkruar, ai person duhet po ashtu të nënshkruajë faturën tatimore”, konsideron se faturat si dokumente në sajë të cilave kreditori kërkon përmbushjen e detyrimit nga debitori, ka prova se janë pranuar dhe nënshkruar nga debitori, prandaj konsiderohen si dokument i besueshëm. Po ashtu, faturat janë dorëzuar në kopje të vërtetuar nga origjinali dhe mbanë nënshkrimin e pranimit nga ana e debitorit. Andaj, faturat nr.19-SHV01-001-7526 dhe fatura nr.19-SHVO1-8184, janë nënshkruar nga debitori dhe konsiderohen si pranimit i rregullt.

Dhoma e Shkallës së Dytë vlerëson se gjykata në shkallë të parë drejtë ka vendosur sa i përket parashkrimit të borxhit sipas Faturës nr. 19-SHV01-001-7526 e datës 06.09.2019 dhe fatura nr.19-SHVO1-8184 e datës 30.09.2019, për të cilat propozimi për përmbarim në raport me këto fatura është paraqitur me datë 22.07.2020, ashtu që sipas dispozitës së nenit 355 të Ligjit për Marrëdhëniet e Detyrimeve (Ligji Nr.04/L-077), në të cilën parashihet afati 3 (tre) vjeçar i parashkrimit për kërkesat reciproke nga kontratat komerciale si dhe kërkesat e shpërblimit të shpenzimeve lidhur me këto kontrata, ndërsa parashkrimi rrjedh veç e veç për çdo dërgim të mallit, pune ose shërbimi të kryer, e që bazuar në faturat e lartcekura është vërtetuar se nga data e lëshimit të faturave e deri në paraqitjen së propozimit për lejimin e përmbarimit nuk kanë kaluar më shumë se 3 vite.

Gjykata Komerciale – Dhoma e shkallës së dytë i vlerësoi edhe të gjitha pretendimet e tjera ankimore por të njëjtat nuk ishin me ndikim për një vendim ndryshe, për çka vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Kompetenca e Dhomës së Shkallës së Dytë për të vendosur nga ana e gjyqtarit individual bazohet në dispozitën e nenit 3 paragrafi 2 të LPP-së, me të cilën është paraparë se në shkallën e dytë vendimet i nxjerr gjyqtari individual.

Nga të gjitha arsyet e paraqitura e në pajtim me dispozitat e nenit 208 dhe 209 paragrafi 1 pika (b) të LPK lidhur me nenin 17 të LPP, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhoma e shkallës së dytë

K.DH.SH.II nr.1512/24 me datë 02.10.2024

**Gjyqtari
Faton Bajrami**